

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR “AD LEDWALL” SHPK

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 06/12/2024 themeluesit kanë krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “**AD LEDWALL” SH.P.K.**

Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Z. Erjon HOTI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 04/05/1991 banues në Shkodër, identifikuuar me Nr. Personal J10504119P, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- **Z. Melidion DERVISHI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 30/07/1994 banues në Shkodër, identifikuuar me Nr. Personal J40730081S, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 2

Objekti


Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Hartimi i planeve të personalizuara për promovimin e produkteve apo shërbimeve.
- Planifikimi dhe zbatimi i reklamave në platforma të ndryshme, si media sociale, TV, apo revista.
- Përgatitja e materialeve vizuale dhe tekstuale si video, foto, postime, dhe artikuj.
- Përmirësimi i faqeve web për të arritur renditje më të lartë në kërkimet online.
- Krijimi dhe monitorimi i profileve të klientëve në platformat si Facebook, Instagram, LinkedIn, etj.
- Dërgimi i fushatave të personalizuara për klientët ekzistues dhe potencialë.
- Studimi i sjelljes së konsumatorëve dhe trendëve të tregut.
- Krijimi i identitetit vizual të një marke, duke përfshirë logo, broshura, dhe materiale të tjera promovuese.
- Xhirimi dhe redaktimi i videove promovionale apo reklamave.
- Bashkëpunimi me influencues për promovimin e produkteve apo shërbimeve.
- Menaxhimi i fushatave të sponsorizuara në Google Ads, Facebook Ads, dhe platforma të tjera.
- Të gjitha veprimtaritë e tjera të lejuara ligjërisht në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e **pakufizuar** nga data e regjistrimit ne Qendrën Kombetare te Biznesit (QKB).



Neni 4
Selia, Adresa e Faqes së Internetit dhe Adresa Elektronike

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Nr. Pasurie 4/408, zona kadastrale 8593 volumi 20 faqe 130.

Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

Neni 5
Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **10,000 Lekë (dhjetë mijë Lekë)**. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues: **Z. Erjon HOTI** kontribut në para, **2,000 Lekë (dy mijë Lekë)**, kuota e zotërimit të kapitalit te shoqërisë **20%**
2. Ortaku themelues: **Z. Melidion DERVISHI**, kontribut ne para, **8,000 Lekë (tetë mijë Lekë)**, kuota e zotërimit të kapitalit te shoqërisë **80%**

Neni 6
Organet Vendimmarrëse të Shoqërisë

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve
- Administratori

Neni 7
Emërimi i Administratorit

Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.

Administrator i parë i shoqërisë **Z. Melidion DERVISHI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 30/07/1994 banues në Shkodër, identifikuar me Nr. Personal J40730081S, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 8
Prishja dhe Likuidimi

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;




- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës;

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë Nenet 191 deri në 2023 të Ligjit 9901.

Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.


Emri dhe nënshkrimi i Ortakëve Themelues

Z. Melidion DERVISHI



Datë: 06.12.2024

Z. Erjon HOTI



Datë: 06.12.2024